



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 09.10.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për anulimin e pjesëshëm të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 405, datë 07.10.2020 dhe caktimin e një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                   |
|---------------------------|-------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>   |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>  |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>  |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>   |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>   |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>   |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>   |
| <b>9. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>  |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Maksim Qoku**.

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për anulimin e pjesëshëm të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 405, datë 07.10.2020 dhe caktimin e një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska parashtron shkurtimisht se në mbledhjen plenare të datës 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar dy kërkesa të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ku pas zhvillimit të shortit elektronik për përzgjedhjen e 2 gjyqtarëve nga Seksioni Penal i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sa i përket çështjeve me numër rendor 1 dhe 2, si të tillë janë përzgjedhur gjyqtarët Ahmet Metaliaj dhe Oltjona Goxha.

Mbas njoftimit të vendimit të Këshillit me nr. 405, datë 07.10.2020, gjyqtarja Oltjona Goxha i është drejtuar Këshillit me një kërkesë me shkrim, duke i bërë të ditur se nuk mund të merrte pjesë në gjykimin e dy çështjeve penale si më lart në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë në kushtet kur në përbërje të trupit gjykues të ngarkuar për gjykimin e këtyre çështjeve ishte motra e saj, gjyqtarja Diamela Goxha, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ekzistenca e papajtueshmërisë ambientele në kuptim të nenit 8, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak të qenies të afërta, motra, të gjyqtareve Oltjona Goxha, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Diamela Goxha, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, rezulton të ketë qenë e panjohur për Këshillin e Lartë Gjyqësor në procedurat e shortit, bazuar në rezultatin e të cilit është marrë Vendimi Nr.405, date 07.10.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, pikat 1 dhe 2, përmes të cilit gjyqtarja Oltjona Goxha është caktuar në përbërje të trupit gjykues për gjykimin e dy çështjeve penale si më lart.

Në këto kushte është vendi për anulimin pjesërisht të pikave 1 dhe 2, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, paragrafit I, të Vendimit Nr.405, datë 07.10.2020, të Këshillit të

Lartë Gjyqësor, sa i përket caktimit të gjyqtares Oltjona Goxha, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si dhe caktimin e një gjyqtari për gjykimin e dy çështjeve penale si më lart në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Lidhur me gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e dy çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, duhet të mbahen në konsideratë propozimet e pranuar nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 07.10.2020, sa i përket gjykatës nga duhet të caktohet gjyqtari, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Seksioni Penal), si dhe sa i përket gjyqtarëve të kësaj gjykate që përjashtohen nga shorti për çështjet penale.

Sa më sipër Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit:

1. Anulimin e pjesshëm të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 405, datë 07.10.2020, paragrafit I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, pikat 1 dhe 2, sa i përket caktimit në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 100/1 i Kodit Penal” dhe çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 139 i Kodit Penal”, të gjyqtares Oltjona Goxha, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Caktimin, me short, në përbërje të trupit gjykues. për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 100/1 i Kodit Penal” dhe çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 139 i Kodit Penal”, të një gjyqtari të Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në propozimet e pranuar nga Këshilli në mbledhjen plenare të datës 07.10.2020.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, penale, gjyqtarja Migena Laska.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

## **Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 09.10.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 405, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b><i>(kryetare)</i></b> |
| <b>2. Medi Bici</b>         | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b>3. Fatmira Luli</b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>  |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>  |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b>6. Ilir Toska</b>        | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b>7. Alban Toro</b>        | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b>   | <b><i>(anëtar)</i></b>   |
| <b>9. Marçela Shehu</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>  |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>   |

<sup>2</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Maksim Qoku*.

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 405, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska parashtron shkurtimisht se në mbledhjen plenare të datës 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shqyrtuar kërkesën e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për caktim gjyqtari për gjykimin një çështjeje gjyqësore të veçantë, ku pas zhvillimit të shortit elektronik, për këtë çështje është caktuar gjyqtarja Lutfije Celami, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nëpërmjet e-mailit të datës 08.10.2020, i ka bërë me dije Këshillit të Lartë Gjyqësor se gjyqtarja Lutfije Celami, e caktuar për të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë çështjen penale si më lart, ishte me leje lindje prej datës 20.04.2020.

Rezulton që kjo rrethanë, pra qenia me leje lindje e gjyqtares Lutfije Celami, të mos ketë qenë e njohur për Këshillin e Lartë Gjyqësor në marrjen e Vendimit nr. 405, datë 07.10.2020, paragrafi I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, pika 1, përmes të cilit gjyqtarja Lutfije Celami është caktuar për gjykimin e çështjes penale në nevojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Në këto kushte është vendi për ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafit I, të Vendimit nr. 405, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes penale si më lart.

Për gjyqtarin që duhet të caktohet për gjykimin e asaj çështjeje gjyqësore të veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, duhet të konsideruar propozimet e pranuar në mbledhjen e datës 07.10.2020, sa i përket gjykatës dhe seksionit përkatës nga duhet të caktohet gjyqtari.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit:

Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”, paragrafi I, të Vendimit Nr.405, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku në bazë të rezultateve të shortit, ndërmjet gjyqtarëve të Seksionit për të Mitur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, të caktohet një gjyqtar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Kostika Çobanaqi.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**